

# **STATUT**

## **SHOQËRIA E RUAJTJES DHE SIGURISË FIZIKE**

### **"NOVO SECURITY" SHPK**

#### **KREU I**

#### **Emërtimi, Forma Juridike, Selia, Kohëzgjatja, Objekti, Vula**

##### **Neni 1**

##### **Emërtimi**

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "NOVO SECURITY" shpk. Emri Tregtar është "NOVO SECURITY".

##### **Neni 2**

##### **Forma Juridike**

Shoqëria "NOVO SECURITY" shpk, është person juridik i krijuar sipas të drejtës shqiptare, e formës shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (në vijim referuar si "Shoqëria"). Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (Regjistrimit), në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqëria pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj. Kapitali i Shoqërisë "NOVO SECURITY" shpk ndahet në kuota. Shoqëria themelohet nga ortakut i vetëm dhe përballon humbjet vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

##### **Neni 3**

##### **Selia**

Shoqëria e ka selinë në Vlorë, Shqipëri, në adresën **Rr.Zenel Murra, L.10 Korriku, Banesë Private me Nr.pasurie 14/299/1 - ND.2, Vlorë.**

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë adresa dytësore të ushtrimit të aktivitetit, të hapë zyrë përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me Vendim të Ortakut të vetëm të Shoqërisë.

##### **Neni 4**

##### **Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (Regjistrimit).

## Neni 5

### Objekti i veprimtarisë

1. Objekti i veprimtarisë është: **“Shërbim Privat i Sigurisë Fizike - SH.P.S.F:**

- **Sigurim fizik i objekteve shtetërore dhe private, i personave, si dhe i veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare e politike;**
- **Sigurim dhe shoqërim i vlerave monetare, materiale dhe sendeve të çmuara gjatë transportit.”**

2. Për realizimin e objektit të përcaktuar më sipër, shoqëria dhe stafi i saj i trajnuar kanë të drejtë dhe janë të detyruar të përdorë/in mjete dhe pajisje elektronike, armë zjarri, qen shërbimi, mjete e pajisje shërbimi, duke marrë masat përkatëse për parandalimin e pasojave përtej atyre të parashikuara me ligj, konform Nenit 32 e vijues të ligjit 75/2014.

Shoqëria do të kryejë shërbime të kategorisë *“Licencë Shërbimi i ruajtjes dhe/ose sigurisë fizike”*, nënkategoritë *I.3.A dhe I.3.B*, konform ligjit nr. 10081 datë 23.02.2009 *“Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë dhe VKM nr. 538 datë 26.05.2009.*

## Neni 6

### Vula

Shoqëria ka vulën e saj, në brendësi të së cilës shkruhet i plotë emërtimi i shoqërisë *“NOVO SECURITY”* shpk

Të gjithë aktet që dalin nga shoqëria, pasi nënshkruhen sipas ligjit, vulosen me vulën e shoqërisë.

## KREU II

### KAPITALI

## Neni 7

1. Kapitali i shoqërisë përbëhet nga aq kuota sa është numri i ortakëve.

2. Kontributi në kapitalin themeltar përbëhet nga kapital në para dhe kapital në natyrë. Kapitali në natyrë konsiston në pasuri të paluajtshme dhe/ose pasuri të luajtshme, dhe/ose të drejta.

3. Kapitali i shoqërisë nënshkruhet nga *“Ortaku i Vetëm”* i shoqërisë. Shlyerja e kapitalit kryhet brenda afatit tridhjetë ditor nga momenti i nënshkrimit të tij. Kapitali në para shlyhet nëpërmjet derdhjes në llogarinë bankare të shoqërisë, ndërsa kalimi i pasurive në natyrë bëhet me akt noterial dhe regjistrimet e detyrueshme parashikuar me ligj.

4. Kontributi në kapitalin themeltar nuk mund të përbëhet nga letra me vlerë të tregëtueshme dhe as me shërbime.

5. Ortaku i vetëm përgjigjet për humbjen e shoqërisë përkundëjt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

6. Kapitali në momentin e themelimit përbëhet nga 100.000 (njëqind mijë) lekë kontribut në para dhe përbëhet nga 1 (një) kuotë me vlerë 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Kuota zotërohet 100% nga ortaku i vetëm i shoqërisë Z. Skënder Meminaj.

## **Neni 8**

### **Mënyra e fitimit dhe kalimit të kuotave.**

1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) shit-blerjes
- c) trashëgimisë
- ç) dhurimit
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar në ligj.

2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

3. Çdo transferim i kuotave tek te tretët behet me vendim të ortakut të vetëm, duke redaktuar dhe akt noterial për transferimin e kuotave.

## **Neni 9**

### **Zmadhimi i kapitalit**

Shoqëria mund të zmadhojë Kapitalin Themeltar në para ose në natyrë (pasuri të luajshme apo të paluajshme) ose mund të zvogëlojë atë, por jo nën kufirin minimal të parashikuar me ligj.

Shtimi ose zvogëlimi i kapitalit bëhet me vendim të ortakut të vetëm të shoqërisë. Dokumenti depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, e cila bën ndryshimet përkatëse.

## **KREU III**

### **ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE**

## **Neni 10**

### **Organi Vendimmarrës**

Ortaku i vetëm është organi i vetëm vendimmarrës i kësaj shoqërie.

1. Ortaku i vetëm është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë.
- b. ndryshimin e statutit.
- c. emërimin e shkarkimin e administratorëve .
- ç. emërimin e shkarkimin e likujdatorëve.
- d. përcaktimin e shpërblimit për personat e përmendur në pikat "c" dhe "ç" të kësaj pike
- dh. Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- e. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- ë. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
- f. pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre,
- g. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit
- gj. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë

h. çështje të tjera të parashikuara në ligj

2. Ortaku i vetëm merr vendime për çështjet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentave përkatëse.

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në regjistrin e vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Në këtë regjistër duhet të regjistrohen veçanërisht:

a. Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.

b. shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve.

c. investimet, zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar

ç. ndryshimet në personat zotërues të kuotave

d. vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

## **Neni 11**

### **Administrimi**

1. Administrimi i Shoqërisë dhe përfaqësimi ligjor i saj i besohet administratorit të saj. Administratori i shoqërisë emërohet për një afat maksimal 5-vjecar me të drejtë riemërimi. Në pozitën e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë, ai gëzon njëkohësisht pozitën e Titullarit të shoqërisë.

2. Drejtues Teknik i shoqërisë ÇERTIFIKATË PËR DREJTUES TEKNIK SUBJEKTI për veprimtarinë: Shërbimi Privat i Sigurisë Fizike, me afat katër-vjecar nga data e lëshimit të saj.

3. Ortaku i vetëm mund të emërojë një ose më shumë individë si administratorë të shoqërisë pa qenë ortak i shoqërisë. Afati i emërimit të tyre nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjetë me të drejtë ripërtëritje.

4. Nëse Ortaku i vetëm emëron më shumë se një administrator, ata administrojnë bashkarisht shoqërinë.

5. Ortaku i vetëm mund të shkarkojë administratorin (që nuk është ortak) me vendim të posacëm.

## **Neni 12**

### **Të drejta dhe detyrimet e administratorit**

a. kryen të gjithë veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare.

b. përfaqëson shoqërinë tregtare

c. kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë.

d. përgatit dhe nënshkruan bilacin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe se bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Ortakut të Vetëm, për miratim.

e. Krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë

f. kryen regjistrimin dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë si parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit

g. raporton përpara Ortakut të Vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.

h. kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut

i. njofton Ortakun e Vetëm për të marrë vendimet përkatëse në rastet kur bazuar në bilancin vjetor, apo raportet e ndërmjetme financiare ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim, si dhe në rast se brenda 2 vjetëve të para të regjistrimit të shoqërisë, Ortaku i Vetëm do të blejë një pasuri me një vlerë më të lartë se 5% të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

j. administratori gjatë kryerjes së detyrës së tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimin e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacionit përkatës veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

k. nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe ligjin, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe të kalojë çdo fitim personal që ai apo çdo person tjetër i lidhur me të kanë përfituar nga këto veprime të parregullta (në përputhje me nenin 98, pika 4 e ligjit 9901 datë 14.04.2008)

l. në interesin e mirë të shoqërisë në tërësi, administratori duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis

m. të ushtrojë kompetencat që lidhen me ligjin dhe në statut, vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita

n. të vlerësojë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendimi

o. të parandalojë dhe mënjojë rastet e konfliktit të interesave personale, prezente ose të mundshme, të interesave personale me ato të shoqërisë

p. të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.

#### KREU IV DREJTIMI TEKNIK

##### Neni 13

Shoqëria ka në përbërje të personelit të ruajtjes dhe të sigurisë fizike Drejtuesi Teknik, i cili është i pajisur/pajiset me Çertifikatën përkatëse për ushtrimin e profesionit dhe plotëson kushtet e parashikuara në ligjin 75/2014 datë 10.07.2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike".

##### Neni 14

Drejtuesi teknik është Drejtuesi më i lartë i shoqërisë dhe përgjegjës për trajtimin, bashkërendimin dhe kontrollin e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike. Kur për shkaqe të ndryshme Drejtuesi Teknik largohet, Shoqëria njofton Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë dhe Brenda 15 ditëve aplikon për certifikimin e tij, sipas dispozitave përkatëse ligjore.

##### Neni 15

Drejtuesi Teknik njofton menjëherë organin e Policisë së Shtetit për çdo ngjarje që ndodh në objektet që Shoqëria ka në ruajtje dhe çdo tre muaj njofton me shkrim për kryerjen e detyrave të ruajtjes dhe të sigurisë fizike si dhe për problemet që kanë lindur.

#### **Neni 16**

Shoqëria Private e Sigurisë Fizike "NOVO SECURITY" shpk ka të punësuar një drejtues teknik për secilën prej kategorive/nënkatëgorive për të cilën ka aplikuar për licencim/është e licencuar. Ndryshimet në Drejtuesin/t Teknik/ë deklarohen pranë QKB.

#### **Neni 17**

Marëdhëniet ndërmjet Shoqërisë dhe personit fizik/juridik që merret në ruajtje rregullohen me marrëveshje të përbashkët, ku pjesë e saj është dhe Rregullorja e Shërbimit dhe sipas rastit Rregullorja e brendshme e objektit/subjektit të ruajtur.

Drejtuesi Teknik asiston për aspekte teknike titullarin e SHPSF-së në nënshkrimin e marrëveshjes apo kontratës me palën kontraktuese për objektet që Shoqëria merr në ruajtje, harton rregulloret për ruajtjen e objekteve dhe është përgjegjës për njohjen e vartësve me legjislacionin, si dhe për organizimin dhe planifikimin e shërbimit.

### **PUNONJËSI I SHËRBIMIT**

#### **Neni 18**

Shoqëria ka në përbërje të personelit të ruajtjes dhe sigurisë fizike një apo më shumë punonjës shërbimi, i cili është i pajisur/pajiset me Çertifikatën përkatëse për ushtrimin e profesionit kur plotëson kushtet e parashikuara në ligjin 75/2014 date 10.07.2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike". Punonjësi i Shërbimit ka përgjegjësi ligjore për ruajtjen e objektit.

### **KREU V DREJTIMI EKONOMIK**

#### **Neni 19**

##### **Viti Financiar**

Viti Financiar fillon në 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Përjashtimisht Viti i parë financiar i shoqërisë fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar shqiptar dhe mbyllet më 31 Dhjetor të po atij viti.

#### **Neni 20**

##### **Bilanci i shoqërisë dhe dividendit**

Brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar, mbledhja e Ortakut të Vetëm miraton bilancin si paraqitur dhe nënshkruar nga Administratori.

Mbledhja e ortakut të vetëm vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jetë zbritur humbja e vitit të mëparshëm financiar, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

#### **Neni 21**

##### **Ekspertët Kontabël**

Shoqëria ka të drejtë të emërojë ekspert kontabël. Ekspertët kanë për detyrë të kontrollojnë të gjithë dokumentacionin financiar të shoqërisë, të veprimtarisë ekonomike tregtare me karakter vjetor ose periodik, në zbatim të një Vendimi të posacëm të ortakut të vetëm.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit financiar vjetor, për hartimin e bilancit si dhe për atë për kontrollin periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë administratorit/ortakut të vetëm për shqyrtim e miratim.

#### **Neni 22**

##### **Bilanci Kontabël**

Bilanci Kontabël vjetor miratohet mbi bazën e vendimit me shkrim nga ortaku i vetëm, i cili jo vetëm që dokumenton miratimin e tyre, por vendos në lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të mëtejshëm të shoqërisë dhe garantimin e veprimtarisë së rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akomodimit, krijimin e fondit të veçantë, etj. konform legjislacionit në fuqi dhe/ose këtij Statuti.

#### **Neni 23**

##### **Dividenti**

Të ardhurat neto (dividenti) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbesin dhe kalojnë në pronësi, ortakut të vetëm të shoqërisë.

#### **Neni 24**

##### **Bashkimi dhe ndarja**

Shoqëria, me anë të bashkimit, mund t'i kalojë kuotat dhe asetet e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ajo themelon.

Shoqëria, gjithashtu me anë të ndarjes mund t'i kalojë kuotat dhe asetet e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.

Ortaku i vetëm i shoqërisë, që merr vendim për bashkimin apo ndarjen e shoqërisë, përfiton pjesë të kapitalit themeltar nga shoqëria ose shoqëritë përfituese dhe sipas rastit një kompensim në para, vlera e të cilit nuk mund të kalojë 10% të vlerës nominale të pjesëve të kapitalit themeltar të dhënë.

Bashkimi ose ndarja sjell prishje apo likuidim të shoqërisë që zhduket dhe kalimin e plotë të trashëgimisë së saj te shoqëritë përfituese, në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashëgimi në datën e realizimit përfundimtar të operacionit.

Bashkimi ose ndarja sjell njëkohësisht për ortakët e shoqërive që zhduken marrjen e cilësisë së ortakëve të shoqërisë përfituese sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e bashkimit ose ndarjes.

#### **Neni 25**

##### **Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja dhe prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilin është krijuar, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në:

a. Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të mëtejshëm të veprimtarisë së saj,

b. Një nga mënyrat e parashikuara nga ligji "Për Falimentimin e Shoqërive Tregtare"

c. Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e shoqërisë tregtare



Në këtë raste Ortaku i Vetëm merr vendimin me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një ose disa likuidator/ë dhe duke u kujdesur të shënojë në cdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër"

#### **Neni 26**

Afati i emërimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve që parashikon ligji duke specifikuar dhe dokumentin që depozitohet në Qendrën Kombëtare të Reegjistrimit.

#### **Neni 27**

Likuidatori është i detyruar që të jetë i vëmendshëm dhe korrekt, si për realizimin e të drejtave për subjektin ndaj të cilëve shoqëria është kreditore dhe për ekzekutimin e detyrimeve, debive që shoqëria ka ndaj shtetit, shtetësve të vecantë apo personave fizikë apo juridikë, vendas apo të huaj.

#### **Neni 28**

Shoqëria Private e Sigurisë Fizike "NOVO SECURITY" shpk, mund të lidhë kontrata me institucione të sektorit publik/ shtetëror, si dhe me individë, persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj.

#### **Neni 29**

Në veprimet kontraktuale Shoqëria përfaqësohet nga Administratori i saj.  
Në cdo veprim në aspektin tekniko-ligjor për shërbimin e ruajtjes shoqëria përfaqësohet nga Drejtuesi teknik përkatës.  
Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontratat me të tretët janë të detyrueshme për Shoqërinë.

#### **Neni 30**

Shoqëria përgjigjet për kontributin fiskal, si sigurimet shoqërore e shëndetësore, tatimet, etj. në afatet e parashikuara me ligj. Ajo ka të drejtë të çelë llogari bankare në cdo bankë të nivelit të dytë vendase dhe të kryejë veprimet financiare nëpërmjet tyre.

#### **Neni 31**

Për sigurimin e veprimtarisë ekonomike shoqëria ka të drejtë të vetëfinancohet në lekë ose në valutë të huaj. Shkëmbimin e monedhës vendase me atë në monedhë të huaj dhe anasjelltas mund ta bëjë në përputhje me kursin e këmbimit si caktuar nga Banka Kombëtare e Shqipërisë, ose në tregun e lirë privat të këmbimit valutor.

#### **Neni 32**

Për pasqyrimet e aktivitetit administratori ose persona të tjerë të caktuar prej tij, janë të detyruar të mbajnë dokumentacionin e rregullt financiar dhe regjistrat përkatës sipas kërkesave të legjislacionit.

### **KREU VI MARRËDHËNIET E PUNËSIMIT**





### **Neni 33**

Ortaku ka të drejtë të vendosë mbi punësimin dhe ndryshimin e administratorit dhe drejtuesit teknik. Administratori i shoqërisë ka të drejtë të nënshkruajë kontratën e punës me stafin tjetër të punësuar. Në cdo rast, për punësimin e punonjësve të shërbimit konsultohet Drejtuesi teknik.

### **Neni 34**

Marrëdhëniet e punësimit brenda Shoqërisë rregullohen sipas kontratës së punës që lidhet midis palëve, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

### **Neni 35**

Marrja në punë bëhet nga Shoqëria në cilësinë e punëdhënësit, në përputhje me kërkesat e Kodit të Punës duke bërë regjistrimet e detyrueshme në librat e Shoqërisë, si dhe para organeve të Zyrës së Punës dhe atyre tatimore në juridiksionin ku ushtron aktivitet Shoqëria, me mjetet në dispozicioni sipas legjislacionit në fuqi.

### **Neni 36**

Ndryshimi dhe largimi nga puna bëhet në bazë të një akti me shkrim të lëshuar nga administratori.

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së Shoqërisë "NOVO SECURITY" shpk në lidhje me kontratat e punës, do të zgjidhen me mirëkuptim mes palëve, të cilat për këtë qëllim mund të caktojnë nga një përfaqësues me prokurë. Kur mirëkuptimi është i pamundur të arrihet, palët i drejtohen Gjykatës.

## **KREU VII TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 37**

#### **Baza ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje me këtë Statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë
- Ligji nr 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"
- Ligji nr.9723 date 03.05.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar
- Ligj Nr.131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit"
- Ligji Nr.75/2014 datë 10/07/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike", i ndryshuar
- Ligji 9920 date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar

### **Neni 38**

#### **Mosmarrëveshjet**



Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij akti themelimi si dhe çdo mosmarrëveshje tjetër që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

### **Neni 39**

#### **Dispozitat Përfundimtare**

Ky Statut u redaktua në 4 ekzemplarë me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi miratohet nga ortaku i shoqërisë tregtare "NOVO SECURITY" shpk nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën në origjinal.

**ORTAKU I VETËM THEMELUES**  
**I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**NOVO SECURITY**

Miratues i këtij Statuti

Z.Skënder MEMINAJ

